

Punëtori tematike në Kumanovë

Më 12 maj të vitit 2008 në Kumanovë u mbajt punëtori në temë “Përfshirja e fëmijëve Rom në sistemin arsimor të Komunës së Kumanovës”. Tema e punëtorisë doli nga propozimet e dhëna në takimin inicial për rrjetëzim në Kumanovë, si edhe problemet e diskutuara në debatin publik.

Qëllimi i punëtorisë tematike ishte të caktohen format për zbatimin e planit aksionar lokal të aprovuar në kuadër të Dekadës për përfshirjen e romëve në sferën e arsimit, si edhe të ndërmerren hapa për përfshirje më të madhe të fëmijëve rom në sistemin arsimor në bashkëpunim me prindërit, nxënësit dhe mësimdhënësit me përkatësi tjetër etnike.

Gjithsej 18 pjesëmarrës morën pjesë në punëtori edhe atë: 13 përfaqësues nga organizatat joqeveritare, 2 përfaqësues të vetëqeverisjes lokale dhe 3 përfaqësues nga institucionet. Atmosfera gjatë tërë punëtorisë ishte shumë konstruktive dhe kjo falë përbërjes kompetente të pjesëmarrësve si edhe prania e të gjithë faktorëve kyç të cilët merren me këtë problematikë – Zëvendës Avokati i Popullit, përfaqësues nga Qendra për punë sociale, përfaqësues nga Komuna e Kumanovës dhe institucionet arsimore si edhe përfaqësues të organizatave joqeveritare të cilat merren me çështjet e arsimimit të popullatës rome.

Pjesëmarrësit i shqyrtuan gjendjet që kanë të bëjnë me implementimin e Planit Aksionar Lokal për përfshirje sociale të romëve nga aspekti i përfshirjes së fëmijëve rom në sistemin arsimor. Nga puna në grupe doli se duhet ridefinuar prioritetet për periudhën 2008-2009 për arsimimin parashkollor dhe elementar, të mesëm dhe atë të lartë.

Plani i ridefinuar aksionar iu dorëzua vetëqeverisjes lokale me qëllim që të aprovimit të tij formal nga ana e Këshillit të Komunës.

Punëtorinë e facilitoi Mario Veljković së bashku me Erol Ademov, pjesëmarrës në programin Trajnim për trajnues.

Punëtorinë e organizoi Fondacioni Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me organizatën partnere “Vlera të përbashkëta” nga Shkupi.